

SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-163/2015

Prishtinë,  
7 dhjetor 2017

Në çështjen juridike të:

V. J.

**Pala ankuese**

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Erdogan Haxhibeqiri, Anëtarë, duke vendosur rreth ankesës kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/244/2014 të datës 18 qershor 2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA06720), pas shqyrtimit të mbajtur më 7 dhjetor 2017, mori këtë

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e V. J. kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/244/2014 përkitazi me lëndën e regjistruar në AKP me numrin KPA06720.
2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/A/244/2014 përkitazi me lëndën e regjistruar në AKP me numrin KPA06720.

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 27 shkurt 2007, V. J. (në tekstin e mëtejshëm: pala ankuese) paraqiti kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejshëm: AKP), fillimisht duke kërkuar vërtetimin e së drejtës së pronësisë mbi ngastrën kadastrale nr. 1324, tokë e kultivueshme e klasës 4 me sipërfaqe prej 06.50.8 ha, që ndodhet në vendin e quajtur "Kod pet duba", Komuna e Lipjanit. Më vonë, pala ankuese konfirmoi se ajo kërkon vërtetimin e së drejtës së pronësisë mbi ngastrën kadastrale nr. 1479, tokë e kultivuar e klasës së 4-të me sipërfaqe prej 01.22.77 ha (faqe nr. 069).
2. Pala ankuese deklaroi se së bashku me motrat e saj ajo është pronare e pronës së kërkuar, të cilën e kanë fituar si shkëmbim për pasurisë që më parë ishte konfiskuar nga babai i saj i ndjerë. Pala ankuese pretendon se humbja e posedimit mbi pronën e kërkuar ka ndodhur si rezultat i rrethanave të viteve 1998/1999 që kanë ndodhur në Kosovë
3. Për ta mbështetur Kërkesën e saj, pala ankuese në AKP i dorëzoi këto dokumente:
  - Vendimin administrativ nr. 464-656, të lëshuar më 21 prill 1992, nga Kuvendi Komunal i Lipjanit, Komisioni i Kërkesave për Kthimin e Tokës. Në bazë të vendimit, Komisioni konfirmoi se të ndjerit D.S. (babai i palës ankuese) iu ishte shpronësuar toka, prandaj kthimi i pronës u miratua për trashëgimtarët e D. S., kështu që, në mesin e pronave të tjera, palës ankuese i përkisnin 1/15 e pjesës ideale të pronës së kërkuar.
  - Deklaratën me shkrim të palës ankuese të dorëzuar AKP-së më 6 nëntor 2013, ku pala ankuese ka deklaruar se që nga viti 1992 kur është marrë vendimi administrativ nr. 464-656, as ajo e as familjarët e saj nuk kanë bërë kërkesë në kadastër për transferimin e pronës në emër të tyre. Sipas deklaratës, në vitin 2013, pala ankuese ka paraqitur kërkesë për transferimin e pronës në Komunën e Graçanicës, Departamentin për Planifikim Urban dhe Kadastër

- Letrën Informuese të lëshuar nga Komuna e Graçanicës më 16 tetor 2013, me të cilën pala ankuese u informua se kërkesa e saj për regjistrimin e pronës sipas vendimit 464-656 ka të bëjë me Pronën Shoqërore. Në bazë të nenit 2 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Nr.03/L-034), pronat shoqërore administrohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.
4. Njoftimi i kërkesës është bërë më 28 janar 2014. Prona e kërkuar u gjet të jetë e zënë nga një person i panjohur, por pasi që asnjë palë nuk parashtrori përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, në pajtim me nenin 10.2 të Ligjit Nr. 03/L-079, kërkesa u konsiderua si e pakontestueshme.
  5. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së e ka gjetur Vendimin Administrativ Nr. 464-656. Megjithatë, zyrtari i komunës së Lipjanit konfirmoi se vendimi kurrë nuk u bë i formës së prerë dhe si i tillë nuk u ekzekutua asnjëherë. Prona e kërkuar është gjetur si pronë shoqërore e regjistruar në emër të "Kooperativës Bujqësore".
  6. Pala ankuese është kontaktuar nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së dhe ajo është këshilluar që të paraqesë dokumente shtesë për ta dëshmuar të drejtën që ajo kërkon. Si një përpjekje shtesë, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së i ofroi palës ankuese një letër informuese duke i kërkuar asaj të dorëzonte dokumente shtesë dhe duke e informuar se nëse ajo nuk i paraqet dokumentet e kërkuara, kërkesa mund të refuzohet nga Komisioni. Letra u pranua nga pala ankuese më 01 Nëntor 2013 (faqja nr. 142 e shkresave të lëndës). Ankuesi nuk iu përgjigj Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së.
  7. Më 18 qershor 2014, KKKPK me vendimin KPCC/D/A/244/2014 e refuzoi kërkesën e palës ankuese me arsyetimin se ajo nuk ka treguar pronësinë apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar menjëherë para ose gjatë konfliktit të viteve 1998 -1999.
  8. Vendimi iu dorëzua palës ankuese më 28 tetor 2014, ndërsa ajo paraqiti ankesë më 19 nëntor 2014.

### **Pretendimet e palës ankuese**

9. Pala ankuese pretendoi se Vendimi i KKKPK-së mbështetet në fakte që nuk janë vërtetuar në mënyrë të plotë dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
10. Sipas palës ankuese, AKP-ja ka deklaruar se Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të verifikojë Vendimin Administrativ Nr. 464-656, sipas të cilit ajo e ka fituar të drejtën e pronësisë mbi pronën e kërkuar. Kjo çështje nuk është e qartë për të, sepse sipas saj Komuna e Lipjanit e ka konfirmuar vërtetësinë e dokumentit në vitin 2011. Ajo thotë se deklarata e bërë nga KKKPK është e papranueshme.
11. Në ankesë, pala ankuese jep një paraqitje të hollësishme të dokumenteve që ajo ka paraqitur për ta konfirmuar të drejtën e saj të pronësisë.

## Arsyetimi ligjor

### Pranueshmëria e ankesës

12. Ankesa është paraqitur brenda 30 ditësh sikurse parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr.03/L-079 dhe është e pranueshme.

### Meritat e ankesës

13. Gjykata Supreme e shqyrtoi vendimin e ankimuar në përputhje me dispozitat e nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006 (tani e tutje: LPK) dhe pas vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese, konstatoi se ankesa është e pabazuar.
14. Gjykata Supreme konstaton se KKPK ka nxjerrë një vendim korrekt kur e ka refuzuar kërkesën.
15. Në pajtim me nenin 3.1 të Ligjit 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër nga KKPK-ja për ri-posedimin e pronës, nëse paraqitësi i kërkesës "dëshmon" të drejtën e tij/saj të pronësisë ose të drejtën për të shfrytëzuar një pronë private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, si dhe dëshmon se ai/ajo nuk është në gjendje ta ushtrojë këtë të drejtë për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
16. Sipas kësaj dispozite ligjore, pala ankuese duhej të dorëzonte prova për ta dëshmuar të drejtën e pronësisë ose të drejtën e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme.
17. KKPK-ja e bazon vendimin e vet në faktin se pala ankuese nuk ka arritur që të ofrojë ndonjë dëshmi që mund të verifikohet nga AKP-ja, se ajo si bartëse e së drejtës pronësore gëzon ndonjë të drejtë të pronësisë mbi pronën, si dhe se Sekretaria Ekzekutive nuk ka siguruar ex officio prova të tilla.
18. Vendimi administrativ nr. 464-656, i lëshuar më 21 prill 1992, nga Kuvendi Komunal i Lipjanit, Komisioni i Kërkesave për Kthimin e Tokës, në bazë të të cilit pala ankuese e fitoi të drejtën e bashkëpronësisë mbi pronën e kërkuar, nuk u bë kurrë i formës së prerë dhe si i tillë ai kurrë nuk u ekzekutua.
19. Pala ankuese vetë përmes deklaratës së saj me shkrim deklaroi se që nga viti 1992 kur u mor vendimi administrativ 464-656, as ajo e as anëtarët e familjes së saj nuk e kishin bërë kërkesën në kadastër për ta transferuar pasurinë në emër të tyre.
20. Për më tepër, komuna e Graçanicës më 16 tetor 2013 e njoftoi zyrtarisht palën ankuese se kërkesa e saj për regjistrimin e pronës së kërkuar në emrin e saj ishte refuzuar për shkak të faktit se kërkesa ka të bëjë me pronën shoqërore dhe në pajtim me nenin 2 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të

Privatizimit (Nr.03/L-034), pronat në Pronësi Shoqërore administrohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

21. Ankesa e palës ankuese i përsërit të njëjtat pretendime sikurse ishin theksuar para KKPK-së. Asnjë dëshmi e re nuk ishte ofruar me ankesën.
22. Duke marrë parasysh sa më sipër, Gjykata Supreme konstaton se KKPK-ja ka marrë vendim të drejtë dhe të bazuar gjatë rrjedhës së procedurës së mirëfilltë. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se nuk ka pasur shkelje të të drejtave materiale ose vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike.
23. Në bazë të lartcekurave, në përputhje me nenin 13.3, nën-paragrafi (c) i Ligjit nr. 03/L-079, është vendosur sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### **Këshillë ligjore**

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

***Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit***

***Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it***

***Erdogan Haxhibeqiri, Gjyqtar***

***Bjorn Olof Brautigam, Ushtrues Detyre i Referentit të EULEX-it***